



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 16 dt. 30.05.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 30.05.2014, pasi shqyrtoi projektet sipas rendit të dites, për pikën I të diskutimit të projekteve,

VENDOSI:

1. **Miratohet:** Projekti "Restaurimi kisha e Shën Spiridhonit" Vuno, Vlorë. Ngarkohet Drejtorja Rajonale e Kulturës Kombëtare të hartojë projektin konstruktiv të kapriateve.
2. **Miratohet:** Projekti "Rindërtimi i banesës ku u ngrit flamuri", Korçë.
3. **Nuk miratohet:** Projekti "Konservimi i zonës veriore të qytetit antik të Butrintit", Sarandë. Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Butrint, të respektojë procedurat ligjore të shqyrtimit të problematikave nga institucionet e parashikuara me ligj.
4. **Miratohet:** Projekti "Ndriçimi i murit të kalasë së Durrësit", Durrës.
5. **Miratohet:** Punime konservimi të pikturës murale të nxjerra gjatë restaurimit të kupolës në objektin e xhamisë së Iljaz Bej Mirahorit, Korçë. Zbatimi i projektit të bëhet në bashkëpunim me specialistët e DRKK Korçë dhe IMK.
6. **Miratohet:** Projekti i rrugës "Qafa e Luadhit – Amantia", Vlorë.
7. **Miratohet:** Projekt "Restaurimi i ish banesës së Petraq Sotës, sot në pronësi të Eneleida Mazzota M-133", lagja Mangalem, Berat.
8. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
9. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI